



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.3.2022, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Nasip Naço – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit datë 31.01.2022, 08.02.2022 dhe 09.02.2022.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe zbatimin e kontratës me shoqërinë “Jones Group International” për forcimin e sigurisë kibernetike” në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Marrin pjesë:

Nasip Naço, Xhemal Qefalia, Ferdinand Xhaferraj, Antoneta Dhima, Bardhyl Kollçaku, Vullnet Sinaj, Pranvera Resulaj, Denis Deliu, Lindita Metaliaj, Ervin Salianji, Enkelejd Alibeaj, Kasem Mahmutaj, Flamur Noka, Isuf Çelaj, Agron Çela, Desantila Tahiraj, Klevis Xhoxhi.

Mungojnë:

Paulin Sterkaj, Toni Gogu, Luan Duzha, Ilirian Pendavinji, Luan Baci.

Të ftuar:

Ardi Veliu – Zëvendësministër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Kledia Ngjela - Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastruktura dhe Energji.
Daniel Shima – Zëvendës drejtor i AKSHI-it
Hava Delibashi – Drejtore juridike e AKSHI-t

HAPET MBLEDHJA

Nasip Naço - Përshëndetje të gjithëve, të nderuar kolegë!

Hapim mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare me këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit datë 31.1.2022, 8.2.2022 dhe 9.2.2022.

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe zbatimin e kontratës me shoqërinë “Jones Group International” për forcimin e sigurisë kibernetike” në cilësinë e komisionit përgjegjës. Relator është zoti Xhemal Qefalia.

Të ftuar janë zoti Ardi Veliu, zëvendësministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, zonja Kledia Ngjela, drejtore e Përgjithshme në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji, zoti Daniel Shima, zëvendës drejtor i AKSHI-t dhe zonja Hava Delibashi, drejtore juridike e AKSHI-t.

Faleminderit!

Fjala është për ju zoti Veliu.

Ardi Veliu – I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Projektligji “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe zbatimin e kontratës me shoqërinë “Jones Group International” për forcimin e sigurisë kibernetike” ka për qëllim përmirësimin e sistemit të sigurisë kibernetike në institucionet shtetërore në disa aspekte të caktuara të tij, me qëllim mbrojtjen e të dhënave elektrike që administrojnë dhe përpunojnë këto institucione.

Objektivat kryesorë, që synohen të arrihen me këtë akt lidhen me:

Autorizimin e AKSHI-t për të negociuar me shoqërinë “Jones Group International” draftkontratën, me qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit ndërmjet palëve;

përcaktimin e fushave në të cilat do të zhvillohet ky bashkëpunim ndërmjet palëve;

krijimin e grupit të negociimit të kontratës me përfaqësues nga disa

institucione shtetërore;

miratimin e procedurave vijuese për realizimet e projekteve.

Miratimi i projektligjit që po paraqitet do të fillojë realizimin e hapave të nevojshëm ligjore, me qëllim realizimin e qëllimit final, që janë mbrojtja dhe përmirësimi i sistemit të të dhënave elektronike të përdorura nga institucionet shtetërore.

Në lidhje me shoqërinë “John Group”, sqarojmë se është një shoqëri e

regjistruar në Republikën e Shqipërisë, që ushtron veprimtarinë në fushën e konsulencës, të zgjidhjeve të produkteve në fushat e sigurisë kibernetike, energjisë, telekomunikacionit, inxhinierisë, transformimit organizativ, çështjeve tregtare dhe politike.

Kjo shoqëri është degë e shoqërisë së huaj “Jones Group International”, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me qendër në Virxhinia të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e themeluar në 14.7.2011 dhe me kapital tërësisht amerikan. Kjo shoqëri ka një ekspertizë që pikas në fushën e dhënies së ekspertizës dhe ka përfunduar me sukses në vendin tonë dy projekte në sigurinë kibernetike dhe 5G.

Detyra e “Jones Group” është dhënia e një asistence të plotë që përfshin një analizë dhe rishikim gjithëpërfshirës të sigurisë së infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe sistemeve digjitale në vend. Kjo asistencë do të ndihmojë të zbulojmë dobësitë dhe kërcënimet, duke shfaqur lidhje të dobëta dhe praktika vepruese me rrezik të lartë.

Auditi kibernetik i kërkuar në formën e asistencës nga “Jones Group” është një metodë primare për ekzaminimin e pajtueshmërisë dhe për të vlerësuar kundrejt një standardi specifik për të vërtetuar që nevojat e sakta janë përmbushur.

Dukshmëria e sigurisë, zbulimi dhe reagimi i incidentit mund të përshpejtohen dhe përmirësohen shumë si rezultat i këtij konsolidimi. Ky forcim i sigurisë shkon për përmirësimin e vazhdueshëm drejt modeleve të avancuara të sigurisë kibernetike si mbrojtja proaktive kibernetike dhe mbrojtje e drejtuar nga inteligjenca.

Ky projektligj është në përputhje me programin e qeverisë 2022-2023, vjen në vijim të vendimit të Këshillit të Ministrave, të datës 11.1.2022 “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe “Jones Group International” për forcimin e sigurisë kibernetike të infrastrukturës kritike për Shqipërinë.

Ky akt është në koherencë të plotë me të gjitha politikat e qeverisë në kuadër të rritjes së sigurisë kibernetike në vend.

Projektligji nuk parashikohet të sjellë asnjë problematikë apo efekt të pritshëm negativ gjatë zbatimit të tij, pasi kemi të bëjmë me një akt rregullator, i cili i hap rrugën kryerjes së procedurave të tjera negociuese, me qëllim realizimin në praktikë të këtij projekti të madh e mjaft të nevojshëm për sigurinë kibernetike në vend.

Ky projektligj do të ketë mjaft efekte pozitive. Zbatimi i projektaktit të propozuar do t’i hapë rrugën negociimit të kontratës, e cila do t’u ofrojë institucioneve vendase shtetërore kryerjen e vlerësimeve kibernetike gjithëpërfshirëse për çdo agjenci civile qeveritare dhe agjenci të mbrojtjes kombëtare, duke na bërë institucione më të sigurta dhe të afta për të qenë partnere të shteteve të tjera anëtare të NATO-s.

Sikurse u përmend më lart, ky akt del si një kërkesë për të vijuar me realizimin e kuadrit rregullator, me qëllim përmirësimin më tej të sistemit kibernetik të vendit. Akti nuk transponon asnjë rregullore apo direktivë të Bashkimit Europian, pasi bazohet në të drejtën kombëtare të vendit tonë dhe pikërisht në Kushtetutën e vendit. Ai është në përputhje me të gjithë legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Projektakti parashikon, para së gjithash, autorizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, që, në cilësinë e autoritetit kontraktues, të negociojë dhe të lidhë një kontratë shërbimi me shoqërinë amerikane “Jones Group” për realizimin e shërbimeve të mëposhtme:

- Kryerjen e vlerësimeve kibernetike gjithëpërfshirëse për çdo agjenci civile qeveritare dhe agjenci të mbrojtjes kombëtare;
- hartimin e planeve të transformimit kibernetik për secilën agjenci, të pasuara nga zbatimi i këtyre planeve të transformimit;
- asistimin e qeverisë shqiptare për të zhvilluar, zbatuar e operuar një Qendër Kombëtare të Operacioneve të Sigurisë Kibernetike (QOSK) për qeverinë shqiptare dhe agjencitë e saj, për të përfshirë zhvillimin e teknologjisë dhe të ndërfaqeve të nevojshme;
- dhënien e asistencës për krijimin e Qendrës Shqiptare të Ekselencës për Sigurinë Kibernetike në Tiranë.

Në këtë kuadër, përveç fushave të veprimtarisë ku do të fokusohet

bashkëpunimi, akti i propozuar parashikon edhe mekanizmat ligjorë me anë të të cilit do të realizohet ky bashkëpunim. Në këtë kuadër, projektligji parashikon që bashkëpunimi do të realizohet mbi bazë të dhënies së të drejtës së shërbimeve të sipërcituara pa konkurrim, por nëpërmjet procedurave negociuese të kontratës ndërmjet palëve, negociim, i cili, nga ana e qeverisë së Republikës së Shqipërisë, do të drejtohet nga AKSHI dhe do të ketë në përbërje të saj përfaqësues të institucioneve ekzekutive kryesore në vend.

Gjithashtu, akti i propozuar parashikon edhe vijimin e procedurave të negociimit të kontratave sektoriale, përsëri me autoritet kontraktor AKSHI-n, referuar fushës së përgjegjësisë shtetërore të saj, por me prezencë në negociata të përfaqësuesve të secilit sektor, pjesë e agjencive shtetërore të vendit, me qëllim realizimin e përfitimit e produkteve cilësore të përftuara.

Projektakti i propozuar parashikon të gjithë procedurën negociuese të projektakteve, që do të vijnë në dhe për zbatim të këtij akti, në rast të miratimit të tij nga Kuvendi i Shqipërisë, afatet procedurale dhe ligjore, mënyrën e ekzekutimit të kantatave etj.

Sikurse e cituam edhe më sipër, kemi të bëjmë me një akt lejues/autorizues dhe rregullator në të njëjtën kohë, i cili do t’u hapë rrugën një sërë veprimeve të

tjera ligjore, me qëllim kontraktimin e drejtpërdrejtë të shoqërisë amerikane në realizimin e një sistemi të përshtatshëm e bashkëkohor kibernetik, i cili do të

parandalojë sulmet kibernetike ndaj agjencive vendase dhe jo vetëm, si dhe do të plotësojë një prej detyrimeve kombëtare në kuadër të marrëdhënieve

ndërkombëtare si vend anëtar i NATO-s.

AKSHI është institucioni kryesor zbatues i këtij akti, por, për aspekte të veçanta të aktit, do të bashkëpunojë me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

Në një botë ku teknologjia është gjithnjë e më e pranishme në çdo qelizë të zhvillimit në shërbimet nga më të thjeshtat deri tek ato më kritiket për sigurinë kombëtare, vendosja e një sistemi sigurie në fushën numerike është domosdoshmëri për të ruajtur të gjithë aktorët, ekonominë dhe sigurinë e vendit nga ndërhyrjet e paautorizuara, qofshin ato amatore, kriminale apo të krimit të organizuar.

Forcimi i sigurisë kibernetike, që po kërkojmë, do të ofrojë nivelin më të lartë të sigurisë për procesin e menaxhimit të rrezikut kibernetik. Ai shton një linjë shikimi për të vlerësuar dhe për të përmirësuar menaxhimin e koordinuar të sigurisë.

Sa më sipër, duke ju falënderuar, kërkoj mirëkuptimin tuaj që ta miratoni këtë projektligj.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Veliu!

Ervin Salianji – Është teknike më shumë ndërhyrja ime: nëse mundet ta lexojë pak më rrjedhshëm dikush nga qeveria, që ta kuptojmë, se ishte me shumë gërmëzime, meqenëse nuk e kemi as të shkruar si dokument.

Është kërkesë procedurale, po të ketë një përfaqësues tjetër, që ta lexojë. Kjo është një kërkesë e thjeshtë, se është një botë teknologjike.

Është një kërkesë, po e pranuat mirë, po nuk e pranuat, rrezojeni!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Salianji!

Jeni në lartësinë e detyrës sot, mbi lartësinë e detyrës, madje.

Urdhëroni, zoti Qefalia!

Xhemal Qefalia – Në fakt, kolegu Salianji është në të drejtën e tij, varet se si e ka mënyrën e interceptimit, ndërsa për mua, në cilësinë e relatorit, zëvendësministri ishte shumë i qartë, shumë i kthjellët, madje mënyra se si e parashtrori këtë projektligj është shumë bindëse, pasi kjo marrëveshje dhe ky projektligj, tashmë në dispozicion të anëtarëve të Komisionit të Sigurisë, vjen pas Memorandumit të nënshkruar në janar të këtij viti.

Unë nuk do të zgjatem shumë, pasi zëvendësministri i citoi gjërat kryesore, vetëm dua të them që, nisur nga situata aktuale, nga lufta në Ukrainë që është një luftë, e cila tashmë ka ekspozuar jo vetëm gjithë armatimin dhe arsenalin e provuar në poligonet e qitjes, por tashmë po konkretizohen në terren. Kjo është një luftë gjithëpërfshirëse që përfshin edhe sistemin kibernetik.

Memorandumi i nënshkruar në fillim të këtij viti është përfaqësuar nga një figurë shumë e lartë ushtarake e forcave ushtarake të SHBA-së, madje kemi të bëjmë me një gjeneral me katër yje të marinës amerikane, me komandantin e trupave të marinsave. Njëkohësisht, detyrën e tij e ka ushtruar edhe në Europë, jo vetëm si lider i komandës së SHBA-së në Europë, por edhe si komandant suprem i aleancës së NATO-s. Duke e parë në këtë këndvështrim, unë nuk do të ndalem gjatë, vetëm do t'i ftoj kolegët, natyrisht, pa u hequr të drejtën e tyre për të diskutuar, por në fund ta miratojmë këtë akt, pasi kjo i shërben edhe sigurisë kombëtare në tërësi, duke pasur në konsideratë që ne jemi vend anëtar i NATO-s.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Qefalia!

Të nderuar kolegë,

Para se të fillojmë me pyetjet dhe diskutimet, unë do të doja që përfaqësuesve dhe të ftuarve t'u bëja disa pyetje.

Pyetja e parë ka të bëjë me nenin 8, shpenzimet financiare, pikën 2, ku thuhet: “Ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë bën rimbursimin e shpenzimeve për ekspertin ligjor dhe/ose teknik të përcaktuar në pikën 5 të nenit 3 të këtij ligji”.

Në nenin 3, pika 5 e këtij ligji thuhet: “Ngarkohet AKSH-i të thërrasë mbledhjen e parë të komisionit të negocimit brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.

A ka nevojë për redaktim?

Pyetja e dytë ka të bëjë me faktin se në relacionin e Komisionit të Ligjeve, është bërë propozimi që në komisionin e negocimit të shtohen dy pika. Zonja Felaj sugjeron për Komisionin e Sigurisë Kombëtare, si komision përgjegjës, që referuar nenit 3, pika 2 të projektligjit, ku parashikohet përbërja e komisionit të negocimit të procedurës, të përfshihen në komisionin e negocimit, edhe përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kombëtare, si dhe një përfaqësues nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DISIK), si dhe pajisja e këtyre anëtarëve që do të negociojnë kontratën me certifikatë sigurie, sipas legjislacionit në fuqi.

Këto janë pyetjet nga ana ime.

Urdhëroni, zoti Salianji!

Zoti Saliani, ju sjell në vëmendje që Kodi Etik...

Ervin Salianji – Mos më tërhiq vëmendjen!

Së pari, pse nuk ka një vlerë që ta dimë ne dhe publiku, ose sa është vlera, nëse ka një vlerë në total?

Së dyti, siç edhe po ndodh në përgjithësi me të gjithë procedurat problematike në Shqipëri, të gjitha paratë publike po shkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa ndjekur rrugën ligjore, pa prokurim, pa oferta të ndryshme. Pse është zgjidhur prapë një rast që procedura të bëhet me ligj të posaçëm dhe jo të ndiqet procedura normale ligjore për të zgjedhur ofertën më të mirë? Në këtë vend po ndodh, siç ndodhi së fundmi, që për një zgarë hekuri në Kamzë, vdiq një njeri dhe disa personave të tjerë, përfshirë edhe punonjësve të Policisë së Shtetit që iu rriskua jeta. Pra, u bënë shumë raste.

Së treti, deri më sot, a ka pasur sulme apo probleme apo rrjedhje në ndonjë institucion për shkak të pasigurisë, që ka lindur nevoja për të bërë këtë procedurë?

Faleminderit!

Nasip Naço - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një parashtrësë të vogël, pa lënduar askënd, dhe pastaj pyetjet.

Së pari, po i referohem asaj që kolegu Qefalia tha, me shumë respekt, për ta sjellë diskutimin në hullitë e logjikës dhe të asaj çfarë ky komision dhe ky parlament ka.

Ne si komision nuk jemi këtu për të vlerësuar figurën e gjeneralit Jons, aktet e veta heroike, po e po, por nuk është kjo arsyeja, motivi për të cilin jemi mbledhur sot këtu. Do të duhet që diskutimin, siç i ka hije parlamentit, ta orientojmë drejt asaj se çfarë na sjell një projektligj në thelbin e vet, i cili ka natyrën e një projektligji special për natyrën e një çështje unike, e cila ngërthen çështje të mirëmenaxhimit, nga njëra anë, të sigurisë kibernetike dhe, nga ana tjetër, të financave të publikut. Kjo ishte parashtrësia.

Tani kalojmë te pyetjet, që edhe mund të jenë mbivendosur tek ato që zoti Salianji tha, por po i ripërsëris me shpresën e vakët që mund të jem më i qartë.

1. Ka ardhur një projektligj. Duket që ka ardhur për shkak të nevojës së rritjes së sigurisë kibernetike. Pyetja është kjo: Cili autoritet e ka krijuar, e ka konkluduar, e ka analizuar këtë nevojë të rritjes së sigurisë kibernetike? Me çfarë akti? Nëse ka një akt të tillë, a mund të njihet Komisioni i Sigurisë?

2. Është një ligj special, sipas opinionit tim modest, i cili bën fjalë për një kontratë që do të lidhet, madje, sipas opinionit tim, gjithmonë modest, në brendinë e tij ka terma kontraktuale, i referohet një procedure të vetme, i referohet një subjekti të vetëm, që është “Jones Group”.

Ky parlament ka njohur disa ligje speciale, njëri prej të cilëve është ligji special për teatrin. E veçoj këtë nga ligjet e tjera, sepse speciale kanë qenë ligjet për Rrugën e Arbrit, për Portin e Karpenit, për Aeroportin e Vlorës e me radhë, i teatrit po ashtu, por ka njohur diçka më ndryshe ky i teatrit, siç e dimë të gjithë, ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, i cili në brendinë e vet, ka dhënë këtë konkluzion në lidhje me ligjet speciale që ngërthejnë çështje ekonomike. Ligjet speciale bien ndesh me nenin 11 të Kushtetutës, me lirinë ekonomike. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ky parlament, e madje edhe ata që iniciojnë, që në këtë rast është qeveria, nuk duhet të eksplorojnë rrugën e miratimit të ligjeve speciale, sepse janë destinuar për të qenë antikushtetues.

Pyetja ime është: a e keni pasur parasysh këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese? A keni gjetur arsye të tjera për të mos qenë i ngjashëm me fatin e ligjit special për teatrin apo ligjet e tjera? Kjo ishte pyetja e dytë.

Pyetja e tretë. Edhe nga diskutimet që u bënë në Komisionin e Ligjeve, po të doni ju edhe me ndihmën e kolegëve tuaj, Republika e Shqipërisë, Parlamenti i Shqipërisë, ka miratuar dy ligje, të cilat janë të vetmet që i dedikohen mënyrës se si shpenzohen paratë e buxhetit të shtetit. Është ligji “Për prokurimin publik” si një ligj kuadër, siç është edhe një ligj tjetër, i cili i dedikohet prokurimeve në fushën e mbrojtjes, dhe besoj se ky është një prokurim në fushën e mbrojtjes. Pra, është ligji “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes”.

Të dy këta ligje parashikojnë rregullat dhe mënyrat se si prokurohet. Parashikojnë qoftë alternativën me garë të hapur, me garë ndërkombëtare, me negociim pa shpallje, por po të doni ju edhe duke gjetur drejtpërdrejt subjektin me të cilin qeveria do të negociojë. I ka të gjitha.

Nasip Naço – Zoti Alibeaj, nëse doni të bëni diskutim, vazhdojmë!

Enkelejd Alibeaj – Po bëj pyetjet pra!

Nasip Naço – Unë e kam në dorë që të fillojmë me diskutime nga ana e të gjithë kolegëve.

Enkelejd Alibeaj – Zoti Naço...

Nasip Naço – Po tani bëj pyetje, të lutem!

Enkelejd Alibeaj – Pyetja është kjo...

Nasip Naço – Jo, jo, s'ka edhe pyetje, edhe diskutim. Eja të bëjmë diskutim. Biem dakord dhe bëjmë diskutim.

Enkelejd Alibeaj – Të lutem tani! Një pyetje ka edhe parashtresën, në mënyrë që të ftuarit ta kuptojnë.

Nasip Naço – Lëri komentet dhe bëj pyetjet!

Enkelejd Alibeaj – Kjo ishte parashtresa.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Tani, ju lutem, unë besoj se jam i qartë në këtë pikë.

Nasip Naço – Ti po i ezauron të gjitha: edhe pyetje, edhe diskutim.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Zoti Naço, po qe për kooperativë, e flasim...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

A ta mbaroj fjalën unë? Pyetje pra. Kini durim, pra!

Ja pyetja: ligji, ligjet, qoftë “Për prokurimin publik”, qoftë “Për prokurimin në fushën e mbrojtjes” parashikon të gjitha mënyrat e rregullat se si bëhet prokurimi publik. Pyetja është: pse miratoni një ligj tjetër, kur ka një ligj, kur ka rregulla që përcaktojnë përgjegjësinë e atyre, të cilët hedhin edhe firmën në fund? Pse miratohet një ligj special?

Pyetja e katërt. Tani edhe për këtë do të më duhet të bëj një parashtresë, për ta kuptuar.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Nasip Naço – Mos e mëso si të përgjigjet!

Enkelejd Alibeaj – Atëherë, pyetja ime është: si do të jetë dita nesër? Më fal, zotëri, por po bëjmë pyetje të rëndësishme.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Dhe pyetja është kjo...

Nasip Naço – Po e kalojmë në diskutim për të gjithë.

Enkelejd Alibeaj – Po kaloje! Unë kam të drejtën e fjalës. Po të duash fike. Fike atë dhe më thuaj.

Nasip Naço – Nuk e fik, jo. Unë po them që të respektojmë kolegët.

Enkelejd Alibeaj – Për t'i respektuar pra.

Nasip Naço – Bëj pyetje, zotëri, dhe kaq! Të përgjigjen ata.

Enkelejd Alibeaj – Respekt është të bësh një pyetje, që të kuptohet, në mënyrë që edhe përgjigja të kuptohet. Kësisoj, e ezaurojmë, por fitojmë edhe kohë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetja e katërt. E bëra këtë pyetje në Komisionin e Ligjeve, por po e përsëris edhe një herë. Është një ligj, i cili ka gjithë-gjithë njëzet nene. Në këto njëzet nene, janë jo pak, por shtatë raste, ku pretendohet se ky parlament që bën ligje, t'ia kalojë, t'ia delegojë qeverisë të drejtën për të bërë rregulla. Janë shtatë raste. Është një nen në Kushtetutë, dhe duhet ta dini, zoti Naço, me profesionin që keni, se është neni 118, pika 2 e Kushtetutës, i cili përcakton rastet kur parlamenti ia kalon qeverisë të drejtën për të bërë rregulla, në mënyrë që qeveria të mos i mbivendoset rregullave të parlamentit, pra të mos bëjë rregulla që i bien ndesh ligjit. Kësisoj, ka përcaktuar se cilat janë këto kritere, këto garanci. Në projektligj nuk ka asnjë dispozitë, që të respektojë nenin 118 të Kushtetutës. Mjafton vetëm kjo arsye, që qysh në këto momente ligji të konsiderohet antikushtetues.

Pyetja është: pse nuk keni respektuar nenin 118 të Kushtetutës, i cili përcakton garancitë? Cili është autoriteti, rastet kur delegohet, çështjet për të cilat delegohet qeveria, por mbi të gjitha, çfarë parimesh do të duhet të ndjekë qeveria, që të respektojë vullnetin e parlamentit, për të mos iu mbivendosur vullnetit të parlamentit? Kjo është pyetja e katërt.

Besoj se isha i qartë edhe në parashtrësë, edhe në pyetje.

Faleminderit, zoti kryetar!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Mund të përgjigjeni!

Në qoftë se do të vazhdojmë me pyetje e me diskutime, më mirë të tregohemi korrektë dhe të vazhdojmë të gjithë me diskutime, e kështu jemi *fair*.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Diskutimi nxjerr konkluzion. Unë nuk nxora konkluzion. Nëse më keni parë duke nxjerrë konkluzione, keni të drejtë.

Ardi Veliu – Për sa i përket pyetjes se përse nuk kemi një vlerë, nuk ka si të kemi një vlerë, kur nuk kemi një kontratë. Ashtu siç theksohet edhe në ligj, kjo është një e drejtë apo një detyrë, që i vendoset AKSH-it apo autorizim që i jepet për të negociuar së bashku me sektorët e tjerë, që janë përgjegjës për sigurinë, e pas kësaj të vazhdojë me hapat apo etapat e tjera, që do të ndjekë gjatë konkretizimit.

Pse është përcaktuar se duhet të jetë një ligj i veçantë? Në qoftë se më lejoni, dua të bëj prezent faktin se siguria kibernetike – dhe besoj se të gjithë biem dakord këtu – është pjesë e pandarë e sigurisë kombëtare. Duke qenë e tillë, nuk besoj se duhet të kalojë dhe të ndjekë disa procedura, që janë të rregulluara me ligj, të cilat mund t'u japin mundësi të gjithë operatorëve në treg, që të paraqesin ofertat më të lira, të arrijnë të japin një shërbim të kësaj natyre. Çfarë është më e rëndësishme, duhet të fokusohemi te pjesa e elementëve të sigurisë, që ne duhet të përfitojmë gjatë këtij procesi. Për të pasur elementë, që duhet të jenë të pakontestueshëm dhe në sinkron me të gjitha politikat që ka vendi ynë, si

vend anëtar i NATO-s, ne duhet të kemi një subjekt, i cili do mund të ofrojë të gjitha garancitë e nevojshme për të arritur në një përfundim dhe në një proces, me qëllim që, përfundimisht, edhe Shqipëria të ketë një sistem të sigurtë të mbrojtjes kibernetike, bashkëkohore dhe të pranuar nga të gjitha vendet e tjera të NATO-s.

Sot në tregun e lirë ka lloj-lloj operatorësh, që mund ta ofrojnë këtë dhe mund ta sjellin edhe falas, por a jemi të interesuar ne si shtet, që në kuadrin e marrjes së ofertës më të mirë apo në kuadër të respektimit të një procedure të hapur, të pranojmë një ofertë të kësaj natyre, e cila nesër do të na ballafaqojë me të papritura, të cilat mund të jenë rrezik i shtuar jo vetëm për infrastrukturën kritike civile, që është sot në vendin tonë, por edhe për pjesë të rëndësishme të sigurisë kombëtare.

Kësisoj, nuk dua të jap elementë të tjerë apo cilësime të tjera të veçanta për sa i përket arsyes, por do të doja të vija te pyetja: Cili është autoriteti, që e ka udhëhequr, ose: a kemi një bazë në lidhje me arsyen pse kemi ardhur te ky projektligj?

Unë e theksova pak më parë në fjalën time: udhërrëfyes për hartimin e këtij projektligji është memorandum i datës 11. 1. 2022, i nënshkruar nga qeveria shqiptare. Bazuar në këtë memorandum, është përcaktuar apo është hartuar projektligji që po parashtrojmë sot.

Kledia Ngjela – A mund të vijoj? Faleminderit!

Atëherë, në lidhje me përcaktimin e vlerës, për të cilën u bë pyetja se përse nuk po përmbahet një vlerë apo përse nuk ka një fond limit të përcaktuar në këtë ligj, që në krye të herës, në nenin 1, ku flitet për qëllimin e projektligjit, është autorizimi për procedurën e veçantë të negocimit dhe të zbatimit të kontratës. Kjo do të thotë se pjesë përbërëse e kontratës do të jetë dhe vlera.

Po si do të dalë kjo vlerë? Kjo vlerë është e përcaktuar në nenin 4 nga një studim tregu, të cilin do ta bëjë Komisioni i Negocimit, i paracaktuar me përfaqësues nga institucione të ndryshme të Ekzekutivit dhe nga institucione të tjera. Pra, kjo vlerë do të dalë në një moment tjetër. Nuk mund të përcaktohet tani, kur ne flasim për një procedurë dhe çfarë ne kërkojmë nga kjo procedurë. Ne kërkojmë të autorizohemi, që të vijojmë të negociojmë për këtë procedurë me grupin “Jones”.

Sa i përket autorizimit ligjor në lidhje me hartimin e një projektligji, Këshilli i Ministrave ka vullnetin politik, që në bazë të Kushtetutës, në bazë të nenit 7883, të propozojë e të ndërmarrë nismën për hartimin e një projektligji të caktuar. Neni 118, të cilit iu referuat, bën fjalë për autorizimin ligjor apo nxjerrjen e akteve nënligjore, në zbatim të një ligji të caktuar. Prandaj nuk është parë e udhës, që ne të nxjerrim një akt nënligjor për të kërkuar autorizim për një procedurë të tillë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Patjetër! Neni 118 i Kushtetutës, që iu referuat bën fjalë për autorizimin ligjor, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të një ligji të caktuar. Në këtë rast ne kemi një projektligj. Pra, nuk kemi hartuar një akt nënligjor, një vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave e ka përdorur vullnetin e tij politik në bazë të neneve 78 e 83 të Kushtetutës, për të ndërmarrë një nismë të caktuar në lidhje me këtë projektligj.

Njëkohësisht, ligji “Për prokurimin publik” përcakton edhe fushat e përjashtimit, ashtu sikundër përcakton rregulla të përgjithshme në lidhje me mënyrën e kryerjes së procedurave, por po ashtu ka edhe rregullat e tij përjashtimore. Bazuar në gjithë këtë hapësirë ligjore dhe kushtetuese, ne kemi hartuar këtë projektakt. Sigurisht, i ka kaluar të gjithë filtrat e marrjes së mendimeve nga institucionet përgjegjëse, nga Ministria e Ekonomisë, nga Ministria e Drejtësisë apo dhe nga vetë Departamenti Ligjor i Këshillit të Ministrave. Pra, është një projektakt i filtruar nga të gjitha institucionet që janë të detyruara të japin mendime. Kështu që, sipas gjykimit tonë, nuk mund të themi se kemi të bëjmë me një akt antikushtetues apo një akt që nuk mund të dalë në zbatim të bazës ligjore që ka përcaktuar Kushtetuta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nasip Naço – Zoti Veliu, mund të vazhdoni! Ne duam qëndrimin tuaj! Pastaj komentet janë për në fund.

Më mirëkupto, zoti Alibeaj, nuk kam ndonjë gjë!

Ardi Veliu – Kjo nuk mund të hartohet në bazë të ligjit për prokurimet, se materialet janë në ndihmë apo në funksion të Ministrisë së Mbrojtjes, por nuk mund të bëhet me procedurë të hapur, siç është procedura e zakonshme. Kjo për faktin se siguria kibernetike, siç e përmenda pak më parë, është pjesë e sigurisë kombëtare, por nuk është e shkruar në asnjë nen, në asnjë ligj, në një asnjë akt, ku do mund të thuhej se siguria kibernetike duhet të trajtohet sipas procedurave që ndiqen për prokurimet e mallrave apo të shërbimeve ushtarake.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se të gjithë ju këtu bini dakord me faktin se siguria kibernetike është element thelbësor i sigurisë kombëtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është pra. Për ne absolutisht që është. Këtë po themi. Është pjesë e sigurisë kombëtare. Edhe dje, në komisionin ku ishit dhe ju, unë e përmenda. Pavarësisht pyetjes që ju bëtë: “a keni marrë ndonjë mendim nga NATO në lidhje me hartimin e këtij projektligji”, thashë: jemi konsultuar me strategjinë e mbrojtjes së vitit 2014, që është realizuar me vendet anëtare të NATO-s.

Nasip Naço – Zoti Alibeaj, më mirëkuptoni! Ju i bëtë pyetjet. Lëreni të gabojë dhe korrigojeni në fund! Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, por tani le të mbarojmë, sepse kanë pyetje edhe kolegët e tjerë, që t’i respektojmë.

Zoti Veliu, ju lutem: nuk duhet t’i përgjigjeni asnjë pyetjeje. Keni dy pyetjet e mia. Më pas, fjalën e ka zoti Noka, për pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, zoti Noka! Kam bërë unë dy pyetje, për të cilat s’kam marrë ende përgjigje nga zoti Veliu dhe nga zonjat. E para është për nenin 5, në lidhje me të cilin do të doja një koment nga ana juaj.

E dyta është në lidhje me propozimet e zonjës Felaj, për të shtuar në grupin e negocimit. Më ktheni përgjigje në lidhje me këto, e më pas vazhdojmë me zotin Noka.

Kledia Ngjela – Ndjesë! Keni të drejtë!

Atëherë, në lidhje me konstatimin tuaj të parë, për sa i përket nenit 8, ku është bërë një referencë e gabuar, në fakt është në pikën 5 të nenit 4; nëse e mundur të reflektohet ky sugjerim në përmbajtjen e projektligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Referenca duhej të ishte në pikën 5 të nenit 4.

Sa i përket çështjes së dytë, që ju shtruat, në lidhje me përbërjen e Komisionit të Negocimit, në përbërje të të cilit duhet të ketë një përfaqësues nga autoriteti përgjegjës për sigurinë kibernetike, por njëkohësisht edhe një përfaqësues nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ne shprehemi dakord. Sa i përket pjesës së certifikimit të këtyre personave, duke qenë se projektligji në vetvete përmban disa afate të përcaktuara, të ngushta, çështja është a do të mund t'i respektojmë këto afate në projektligj, për marrjen e certifikatave të sigurisë të anëtarëve të këtij komisioni? Vetëm ky është shqetësimi ynë. Nuk është se shprehemi kundër, por është ideja është: a jemi në gjendje t'i respektojmë afatet? Sepse mund të na duhet kohë, që secili nga anëtarët e komisionit të marrë certifikatën e sigurisë.

Nasip Naço – Më fal! Ju, si mendoni, që këta anëtarë nuk do të kenë certifikatë sigurie, kur kanë gjithë informacionin e klasifikuar?

Kledia Ngjela – Pa diskutim! Unë thjesht e shpreha si shqetësim në lidhje me afatin.

Nasip Naço – Nëse ne do ta vënë në dispozicion, nuk do ta kenë? T'i privilegjojmë?

Kledia Ngjela – Jo, pa diskutim!

Nasip Naço – Falemnderit!

Zoti Noka, fjala për ju!

Flamur Noka – Falemnderit!

Shpreh konsideratën më të lartë për gjeneralin Jones, por sigurisht dhe vlerësimin për kompaninë e tij, për shoqërinë “Jones Group International”. Them: konsideratën më të lartë për gjeneralin Jones, pasi ai është një nga kontributorët madhorë dhe mik i shqiptarëve, por dhe kontributor madhor i procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Sigurisht, Partia Demokratike ka konsideratën më të lartë, dhe e shpreh konsideratën për të.

Doja të ndaja edhe diçka tjetër: jemi absolutisht dakord, që si çdo çështje e sigurisë në këtë vend, edhe siguria kibernetike është e rrënuar dhe në nivele shumë të ulëta, aq sa gjendemi përballë një rreziku real. Sidomos çështja e luftës në Ukrainë ngre një pikëpyetje të madhe rreth sigurisë kibernetike në vendin tonë. Pra, këto të dyja janë në parim.

Ajo për të cilën doja t'ju pyes është: pse nuk ndiqet një procedurë ligjore për një prokurim, qoftë dhe ndërkombëtar, duke përcaktuar kriteret që kompanitë, të cilat mund të hynin në këtë proces, pikësëpari duhej të ishin të njohura në vendet anëtare të NATO-s, të plotësonin të gjitha kriteret që ka

një kompani, siç është në rastin konkret shoqëria “Jones Group International”, por në çdo procedurë, në çdo tenderim, në çdo çështje tenderi apo prokurimi, keni maninë dhe jeni të dashuruar të gjithë si qeveri, keni një dashuri të marrëzishme për negocimin. Çdo procedurë me negocim. E keni prej vitesh këtë. Pse nuk zbatohet kjo procedurë?

Kaq kisha. Falemnderit!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Mirë e ke ti, kur të lejon ligji të vjedhësh! Mirë e ke, por problemi është të mos vidhet. Këtë po themi ne.

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Noka!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zonja Dhima!

Zoti Veliu.

Ardi Veliu – Gjatë fjalës sime, u mundova të bëja një përshkrim të shkurtër në lidhje me kontratat që ka zbatuar tashmë *Jones group* në Shqipëri, me reputacionin që gëzon si kompani qoftë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe me disa kontrata të tjera, që ka lidhur me shtete të tjera anëtare të NATO- s.

Nisur nga gjithë reputacioni pozitiv dhe duke besuar te serioziteti, elementët e sigurisë që ofron, por njëkohësisht edhe cilësia e sistemit që synojmë të ngremë, është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi sa i përket sigurisë kibernetike ndërmjet qeverisë shqiptare dhe *Jones Group*. Ky memorandum bashkëpunimi na ka shtyrë të ecim me hapa të tjerë, për të hartuar këtë projektligj e për t'i dhënë kësaj kompanie të drejtën e menaxhimit të sigurisë kibernetike. Kjo sepse, nëse do t'i referohemi edhe ligjit “Për prokurimin publik”, nuk është se ky ligj parashikon përjashtimin, pra nëse do të respektojmë ligjin për prokurimin e hapur publik apo do të bëjmë një ligj special. Ligji për prokurimet publike nuk bën përjashtime dhe themi që do të vendosim këto kufizime. Dakord, në hartimin e kriterëve...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Po pra, gjatë hartimit të kriterëve do të vendosësh, me dashje apo pa dashje, kufizime dhe bien ndesh me ligjin. Përcaktimi i kriterëve të limituara në vetvete sjellin kufizime.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Nasip Naço – Zoti Noka, ju lutem, bëni pyetje, mos bëni diskutime, ose të fillojmë me diskutime, që të jemi korrekt me të gjitha palët.

Flamur Noka – Zoti kryetar, unë po i them zotit zëvendësministër që të mos ngatërrojë kriteret me kufizimet. Në çdo prokurim kombëtar apo ndërkombëtar ka procedura se si vendosen kriteret. Për sa kohë që je një vend i NATO-s, kriteri numër një është: çdo kompani ka të drejtën për të konkurruar, por duhet të jetë nga një vend anëtar i NATO-s, kjo për çështje sigurie. Kjo nuk bie në kundërshtim me ligjin dhe as me ligjet ndërkombëtare, megjithatë...

Nasip Naço – Shtetet e Bashkuara nuk janë vend anëtar i NATO-s, apo e kam unë gabim?

Flamur Noka – Jo, janë.

Nasip Naço – Po, pra është nga një vend anëtar i NATO-s.

Flamur Noka – Po unë po e pyes: përse me negociim direkt dhe jo me procedurë tenderimi?

Nasip Naço – Dakord, fjala për zotin Veliu.

Flamur Noka – Më fal, e thashë para të gjithëve që gjeneralin Jones e njoh, prandaj shpreh konsideratën më të lartë, sepse është një nga miqtë më të mëdhenj të këtij vendi, është një nga kontributorët, po e përsëris, për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Pra, tjetër gjë është konsiderata, unë po flas për procedurën.

Ardi Veliu – Çdo kriter që do të vendoset në një procedurë të caktuar automatikisht kalon në kufizime dhe në ligjin tonë për prokurimet publike këtë nuk e lejon. Pra, çdo kriter është një kufizim në vetvete.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Veliu!

Të nderuar kolegë, përpara se të fillojmë me diskutimet, nëse keni për të propozuar amendamentet, mund t'i bëni meqenëse kemi dhe përfaqësuesit e qeverisë, ashtu siç bëri zonja Felaj, pra që të jemi konkretë në atë çfarë duam të përmirësojmë në lidhje me legjislacionin.

Fillojmë me diskutimet, zonja Dhima ka kërkuar fjalën.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Dakord, po zoti Deliu.

Denis Deliu – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuar zonja zëvendësministre dhe përfaqësues të AKSHI-t,

Unë e njoh aftësitë dhe profesionalizmin e gjeneralit Jones dhe suksesin e kompanisë së tij. Ai ka qenë këshilltar i Agjencisë së Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka udhëhequr dhe ka marrëveshje me Agjencinë e Sigurisë Kombëtare për Mbrojtjen Kibernetike, siç të gjithë e njohim shërbimin sekret, CIA-n, shërbimi inteligjent i ushtrisë, FBI-në dhe shumë struktura të tjera prestigjioze.

Kam një pyetje për zëvendës drejtorin e AKSHI-t, në çfarë niveli mbrojtje kibernetike ndodhen agjencitë shtetërore në Shqipëri aktualisht? Ky ligj që po diskutojmë sot, me këtë kompani, a mendoni që do t'i plotësojë të gjitha nevojat e Shqipërisë për sigurinë kibernetike?

Faleminderit!

Danjel Shima – Faleminderit, për pyetjet!

Niveli i sigurisë kibernetike në Shqipëri është relativisht i mirë, për aq kohë sa ne kemi marrë dhe marrim sulme në mënyrë të vazhdueshme, por që deri tani janë përballuar në mënyrë të suksesshme. A ka vend për përmirësime? Gjithmonë ka. Ndoshta ne harrojmë që siguria kibernetike nuk vjen me paralajmërim, pra nuk është si lufta fizike që e shikon tankun në fund të rrugës dhe merr masa, pra nëse cenohet siguria kibernetike, merret vesh pasi ka ndodhur. Prandaj lind pyetja: a do ta lëmë ta marrim vesh pasi të ndodhë apo do të marrim masa për ta parandaluar?

Në lidhje me pyetjen nëse plotësohen të gjitha nevojat dhe kushtet e Shqipërisë ky projekt, ne do të përpiqemi që të plotësohen, pasi teknologjia ndryshon çdo ditë.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit!

Meqenëse nuk ka më pyetje, për diskutime ka kërkuar fjalën zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti zëvendësministër dhe përfaqësues, që jeni pjesë e këtij diskutimi shumë të rëndësishëm, i cili vjen pranë Komisionit të Sigurisë Kombëtare, në kushtet ku mbrojtja dhe përmirësimi i sistemit të të dhënave elektronike të përdorura nga institucione shtetërore është shumë i domosdoshëm, por edhe kur qeveria e ka sfidë dhe domosdoshmëri krimin kibernetik, ku një nga prioritetet e saj është siguria kibernetike dhe vendosja e saj në një projekt shumë i rëndësishëm dhe të domosdoshëm.

Me anë të këtij projektligji që po diskutojmë sot, do të bëhet e mundur dhe do t'u ofrohet institucioneve shtetërore, vlerësimet kibernetike për çdo agjenci, qofshin civile apo të mbrojtjes kombëtare. Pra, me nënshkrimin e kësaj kontrate ne do të kemi institucione më të sigurta dhe më të afta për të qenë partnere të shteteve të tjera, që janë anëtare të NATO-s.

Ne jemi në prag të festimit të datës së anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe me miratimin e këtij projektligji ne do të përmbushim edhe disa nga detyrimet kombëtare në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Miratimi i këtij projektligji do t'i hapë rrugë kryerjes së procedurave negociuese dhe njëkohësisht hartimit të projektakteve, të cilat do të vijnë menjëherë pasi ky projektligj do të miratohet në seancë plenare të ditës së enjte.

Duke e vlerësuar si shumë të domosdoshëm, në kushtet në të cilat jemi, sikundër e thashë, që është një nga prioritetet e qeverisë, unë do t'i ftoj kolegët e maxhorancës dhe të opozitës që ta miratojmë këtë projektligj shumë të rëndësishëm dhe të domosdoshëm.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Dhima!

Edhe një herë, diskutantët janë: zonja Resulaj, zoti Alibeaj, zoti Qefalia dhe zoti Kollçaku. A ka të tjerë?

Faleminderit!

Fjala për zonjën Metaliaj.

Linidita Metaliaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky projektligj vjen me kërkesë të Këshillit të Ministrave dhe ka të bëjë me përcaktimin e procedurës së veçantë për negociim, zbatim të kontratës me shoqërinë “*Jones Group Internacional*”.

Gjatë gjithë qeverisjes “Rama 1”, “Rama 2” dhe “Rama 3” ka një tendencë të ripërsëritur dhe një dëshirë shumë të madhe për të shkelur me të dyja këmbët ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Me këtë projektligj, i cili nuk është tjetër veçse një ligj special, si ligjet e tjera, për shembull, si ligji për teatrin, për Rrugën e Arbrit, apo për aeroportin e Vlorës, qeveria “Rama” shkel me të dyja këmbët ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimet publike”, si dhe nenet e Kushtetutës, pasi edhe Gjykata Kushtetuese për një nga ato ligjet speciale, siç ishte ai për teatrin, u shpreh qartë duke e rrëzuar, sepse kishte shkelje ligjore dhe kushtetuese. Pa dyshim tendenca e qeverisë “Rama” është që ta shndërrojë parlamentin në noter të certifikimit të ligjeve speciale, që janë antiligjore dhe antikushtetuese.

Gjatë gjithë relacionit të paraqitur nga Këshilli i Ministrave vëmë re se qeveria “Rama” ka dështuar në argumentimin e arsyeve se përse dikton negociimin, miratimin dhe zbatimin e një kontrate të tillë, duke eliminuar garën, duke mos u dhënë mundësi operatorëve të tjerë ekonomikë që të paraqiten në përmbushje të kriterëve të tyre të përcaktuara paraprakisht, pra duke i hapur rrugë diskriminimit për të mos bërë një garë të hapur dhe transparente.

Në anën tjetër, negociimi i drejtpërdrejtë i hap rrugë abuzimit, këtë e dimë, sepse rritet fondi për buxhetin e shtetit. Pra, nëse merret pjesë në një garë, ku të gjithë operatorët ekonomikë paraqesin alternativën e tyre, pa dyshim që do të zgjidhet ajo që ka koston më të ulët, ndërsa në këtë formë, me negociim të drejtpërdrejtë, pa garë, nesër fondet në buxhetin e shtetit do të kenë një vlerë të lartë, edhe pse deri tani nuk është paracaktuar dhe nuk dihet se sa mund të jetë ky fond. Pra, kështu ne do t’u hapim rrugë abuzimeve në lidhje me përcaktimin e vlerës, duke parë edhe situatën në të cilën ndodhet buxheti i shtetit.

Sot ne jemi në një situatë shumë vulnerabël, sepse kaluam pandeminë, tërmetin dhe po përballemi me pasojat e luftës apo pasluftës së brendshme që sjell keqeverisja e Ramës, me rritjen e çmimeve të shportës, me rritjen e çmimit të karburantit apo me krizën energjetike që po kalon vendi. Si të mos mjaftonin të gjitha këto, do të përballemi edhe pasojat ekonomike që do të sjellë për buxhetin e shtetit ky projektligj me negociim të drejtpërdrejtë.

Qeveria dështoi në sqarimin se përse është përzgjedhur kjo kompani, me gjithë respektin për gjeneralin dhe kompaninë e tij. Nuk dua të merrem fare me emrin se kush është “Jon Group Internacional”, por po e diskutoj në parim. Këtu kemi një subjekt, që është regjistruar në Shqipëri në datën 20.07.2020, i cili ka dy projekte në vendin tonë, por nuk është sqaruar në relacion se cilat janë këto projekte, si kanë ecur dhe cila ka qenë ecuria e këtyre projekteve, në mënyrë që të përzgjidhet në mënyrë të paracaktuar nga ana e qeverisë.

Unë dua t’u tërheq vëmendjen kolegëve, që të jemi të kujdesshëm, të mos kthehemi në noterë, sepse jemi ligjvënës, nuk jemi këtu për noterizuar akte, aq më tepër në shkelje ligjore apo të Kushtetutës, të cilat na vijnë nga tavolina e Kryeministrit apo e Këshillit të Ministrave. Ne duhet të bëjmë atë për të cilën na kanë mandatuar qytetarët, të bëjmë ligjvënësin në zbatim të ligjit dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Metaliaj!

Fjala për zonjën Resulaj.

Pranvera Resulaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Këtu u fol për vlerat e gjeneralit Jones dhe unë dua të ndalem pak. Unë nuk e kisha njohur, por zoti Qefalia e përmendi dhe zoti Noka ma përforcoi atë informacion që më mungonte. Por për t'i dhënë përgjigje pyetjes se çfarë lidhje ka një shoqëri tregtare me emrin dhe vlerat e një gjenerali, atëherë, meqenëse unë vij nga bota e biznesit dhe e njoh atë, dua të them që emri i mirë ka vlerë kontabël dhe të gjithë në biznes e njohin këtë. Zoti Qefalia këtë ka pasur parasysh kur i përmendi vlerat e tij, për të treguar që kjo kompani ofron integritet dhe moral aq të rëndësishëm në këto paragjykime që dëgjojmë në mënyrë të vazhdueshme.

Kam edhe një koment të shkurtër për sa i përket çështjes së një ligji special apo vënies në veprim të ligjit “Për prokurimet publike”, zoti zëvendësministër e theksoi qartë dhe në mënyrë shteruese, të cilin e falënderoj për qartësinë e shpjegimeve që na dha, nëse ne do të shkojmë në kritere specifike, detyrimisht do të kalojmë në kufizime. Për t'u kthyer te zonja Metaliaj, përsëri do të kalonim në diskriminim, përjashtim dhe paragjykim të subjekteve dhe do të vinin këtu apo diku tjetër e do të na thoshin: “kot që nuk i keni vënë edhe emrin e kompanisë kriteritëve ...”

(Ndërhyje pa mikrofon)

Nëse do të ishte në prokurim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sikundër e tha edhe zëvendësministri, ne po flasim për sigurinë kibernetike, pjesë e sigurisë kombëtare që nuk mund të trajtohet si një prokurim i një produkti, i një shërbimi apo madhi çfarëdo, për këtë jemi të gjithë dakord. Do të ishim duke u gjykuar për vjedhje, hajdutëri, sepse kemi vendosur këto kritere dhe nuk i kemi vënë emrin. Ligji e kufizon, sepse kalon nga kriteri në kufizime përjashtuese të drejta dhe të padrejta. E kuptoj shumë mirë dhe nevojën për të nxjerrë gjithmonë në pah që këto bëhen me një qëllim. Pra jeni paragjykses, por kjo është pjesë e juaja.

E përfundoj duke falënderuar përfaqësuesit e ministrisë.

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Resulaj!

Fjala për zotin Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe një herë miqësisht dua t'ia them kujtdo që është këtu, por edhe jashtë, ky nuk është ligji “Jones”, po të ishte i tillë nuk do ta nderonim zotërinë, por përkundrazi do t'i bënim dëm në emrin dhe reputacionin e tij. Ftesë e kam.

Së dyti, ne këtu jemi gardianë të dy gjërave, të kushtetutshmërisë, pra ligjshmërisë, dhe parasë publike, ky është detyrim i deputetëve. Ne jemi përgjëruar përpara zgjedhësve, kemi vendosur dorën edhe mbi Kushtetutë pikërisht për këtë gjë.

Nuk paragjykoj askënd të nderuar, por normat morale që gjithsecili duhet t'i ketë na detyrojnë që të parandalojmë çfarëdo synimi keqdashës që dikush mund të ketë, në mënyrë që të mos arrijmë në situata të tilla, ku sot presim në celularët tonë se sa shkoi numri i të arrestuarve në SPAK për inceneratorët.

Edhe në vitin 2015 ky diskutim ka qenë në atë kohë, që po zbatohet ligjin, jemi për të mirën e vendit, sepse do të pastrojmë Shqipërinë, por sot ka shkuar 20 numri i të arrestuarve.

Unë diskutimin po e bëj teknik dhe gjithsecili ka të drejtën e tij për të nxjerrë konkluzione. Republika e Shqipërisë ka një ligj për prokurimet në fushën e mbrojtjes, miratuar në vitin 2020, pra as 2 vjet nuk janë bërë, ligji nr. 36, i cili në nenin 1 “Qëllimi dhe objekti i ligjit” thuhet se ky ligj, pra ligji “Për prokurimin në fushën e mbrojtjes”, ka si objekt kontratat që lidhen në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”. Përfaqësuesin e qeverisë kur e pyeta tha: “Po, kjo është një çështje që përfshihet te mbrojtja dhe te siguria”, e këtu nuk kemi asnjë lloj diskutimi. Nëse është kështu, nuk ka nevojë për një ligj special, se ja ku është ligji. Autoritetet qeveritare, qeveria, AKSHI, Ministria e Mbrojtjes të marrin përgjegjësinë për zbatimin e këtij prokurimi, përgjegjësinë për ta zbatuar ndershëm dhe për të mos abuzuar me parane publike. Përgjegjësia është individuale dhe gjithsecili prej tyre ta mbajë këtë përgjegjësi, sepse ata paguhen nga taksapaguesit. E para.

E dyta, për të qenë korrekt me ligjin deri në fund, po, ka një dispozitë ky ligj, i cili bën përjashtime dhe thotë se në disa raste përjashtimore nuk zbatohet ky ligj, por zbatohen akte nënligjore apo ligjore të tjera. Për të qenë korrekt me gjithsecilin prej jush, është neni 5. Në pikën 1 të nenit 5 janë përcaktuar këto raste përjashtimore. Por në paragrafin e fundit të kësaj pike, pra në pikën 1 të nenit 5 thuhet një gjë shumë rëndësishme: “Klasifikimi sipas pikës 1 të nenit 5, që do të thotë përjashtimi nga zbatimi i këtij ligji dhe miratimi i një ligji tjetër bëhet nga një komision i veçantë i klasifikimit i ngritur në Ministrinë e Mbrojtjes”. Këtu qëndron i gjithë thelbi. Pra, duhet të ketë një komision të ngritur në Ministrinë e Mbrojtjes, i cili të thotë këtë gjë: nuk zbatohet ligji për prokurimet në fushën e mbrojtjes, i miratuar në vitin 2020, kemi nevojë për një ligj tjetër apo për një akt nënligjor tjetër. Por përgjegjësia është e tyre.

Jo më kot e pyeta përfaqësuesin e qeverisë: a ka një akt të tillë dhe cili është ky autoritet? Nëse do të kishte, atëherë do të ishte pjesë e dokumenteve dhe e relacionit, por asgjë nuk ka. Për sa kohë nuk ka një gjë të tillë, e gjithë procedura e inicimit të këtij ligji, e shqyrtimit në qeveri, aq më tepër edhe në parlament është në shkelje të ligjit. Në kufijtë, po themi, të ndëshkimit moral, por edhe të qortimit penal, sepse situata është fare e thjeshtë miqtë e mi.

Praktika e kësaj qeverie ka treguar që sa herë që bën ligje speciale, gjithmonë fshihet diçka. Çfarë fshihet? Përcjellja e përgjegjësive nga qeveria te parlamenti. Përse bëhet kjo? Kjo bëhet në të gjitha rastet kur bëhet fjalë për shuma parash dhe sa herë që bëhet fjalë për shuma parash, rreziku, alarmi i kuq është gjithmonë. Kjo qeveri e ka treguar se nuk ka asnjë skrupull për të vjedhur.

Pyetja është: përse duhet ta përfshijë Kuvendin? Nëse ka marrë guximin dhe nuk ka skrupuj, siç ka treguar në gjithë këto vite se vjedh, atëherë ta marrë përgjegjësinë edhe penale me të dhe të shikojë pastaj se cila është veprimtaria e drejtësisë së re dhe të shikojmë pastaj se cila është veprimtaria e re e drejtësisë, SPAK-ut. Pra, kjo është ajo që po ndodh dhe kjo është arsyeja thelbësore përse ky parlament nuk duhet ta miratojë këtë ligj. Këtu nuk jemi duke vendosur ndonjë kufizim ndaj të nderuarit, gjeneralit Jones dhe kompanisë së tij, përkundrazi, me këtë procedurë antiligjore po ndryjmë edhe emrin

e tij, madje edhe qëllimin e mirë për të garantuar sigurinë kibernetike. Kemi ne nevojë për siguri kibernetike? Kemi shumë madje. A jemi të vonuar? Jemi të vonuar. Jemi një vend ku të dhënat personale dalin sheshit, ne kemi shumë nevojë, por të bëhet sipas ligjit dhe me seriozitetin maksimal dhe jo të jetë një iniciativë e tillë që t'i japë shkas qeverisë, siç ka treguar në të gjitha rastet, që me justifikimin e sigurisë kibernetike të vjedhin disa para, për të qenë sa më i drejtpërdrejtë. Pra, ky është alarmi që ngremë ne. Puna të bëhet, qëllimi të arrihet, të konsultohet madje edhe me NATO-n, sepse është një nga kërkesat e këtij ligji, që duhet konsultuar me NATO-n. Nuk mund të thuhet këtu që ne e kemi parë strategjinë e NATO-s, por duhet të jetë një kërkesë direkte. Ka institucione NATO-ja, të cilat kthejnë përgjigje, sepse është detyrim ligjor, jo thjesht dhe vetëm një detyrim moral. Më pas jo vetëm që puna të bëhet dhe të bëhet mirë, por të bëhet edhe shpejt, sepse, ndërkohë, që ne ecim me këtë historinë e miratimit të ligjit, të debatit në parlament, të shpalljes nga Presidenti e me radhë, koha ka ikur, ndërkohë që qeveria, AKSHI, Ministria e Mbrojtjes kanë zhdërvjelltësinë, siç e ka ekzekutivi, të ecnin shpejt. Për këdo mendje të arsyeshme e gjithë kjo spirale e miratimit të një ligji të posaçëm (po jua them edhe një herë që Gjykata Kushtetuese ka treguar tashmë se ligjet speciale nuk mund të miratohen, sepse janë antikushtetuese), çdo njeri me dy pare mend e mendon në mënyrë të arsyeshme se kjo është një procedurë, e cila vjen erë, po e them këtu, ashtu siç e thashë edhe te Komisioni i Ligjeve. Ky është diskutimi që kam dhe është ftesë për këdo nga ju, kolegë.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, është për t'u habitur që vazhdon dhe mban po të njëjtën linjë kolegu Alibeaj, linjë që e ka mbajtur edhe në Komisionin e Ligjeve, ku ka pasur edhe kolegë të tij, të cilët e kanë kundërshtuar. Ndoshta ta prish biografinë, zoti Noka, por më vjen mirë që jeni shumë konsekuent dhe i njihni vlerat e një njeriu, i cili ka ndërmjetësuar për ta pasur Shqipërinë në NATO, siç është gjenerali, i cili nuk vjen këtu që të vendosë fytyrën e tij për të përfituar lekë nga Shqipëria dhe këtë duhet ta kuptojë kushdo. Këtë duhet ta kuptosh edhe ti, zoti Alibeaj, dhe kushdo tjetër, që nuk ka ardhur një përfaqësues i një kompanie kaq prestigjioze, që të përfitojë nga fondet e Shqipërisë.

E përmendi shpesh fjalën “teatër”, por këtu nuk bëhet fjala për teatër artistik, zotëri, sepse edhe teatri ka vlerat e tij. Këtu jemi në kushtet e një teatri lufte, e një teatri të një domosdoshmërie për të ndërhyrë sa më parë në luftën që i bëhet këtij sistemi, sistemit kibernetik. E them këtë dhe i mëshoj shumë kësaj gjëje, sepse nuk kemi pse të fshihemi. Është skandaloze nxjerrja e të dhënave, por do të jetë superskandaloze dalja e të dhënave të një rëndësie shumë më të veçantë. E thashë edhe në hyrje të fjalës sime, që ne jemi një vend anëtar i NATO-s dhe kemi përfaqësues të shtabeve të NATO-s në Shqipëri nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. A e kuptoni ju se çfarë do të thotë të merren këto informacione? Ju po thoni sikur ky projektligj ka ardhur këtu dhe është lidhur kontrata. Jo, zotëri, kjo i jep akses, i jep dritën jeshile për të negociuar, pra, ne nuk po nënshkruajmë marrëveshje. Këtu ka një

komision, që e përmendi me të drejtë edhe zëvendës drejtori i AKSHI-t, i cili nuk përfshin, zotëri, vetëm Ministrinë e Mbrojtjes, siç e citon ti dhe na lexon pjesë nga ligji special, këtu janë përfaqësues të një spektri të gjerë. Pra, këtu nuk kemi të bëjmë me një sërë sistemesh, por kemi të bëjmë me një sistem në tërësi. Kemi përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes, nga Ministria e Rendit, kemi përfaqësues nga Avokatura e Shtetit, nga Ministria e Financave, nga Ministria e Infrastrukturës, pra kemi një ekip, i cili do të shikojë me përgjegjësi mënyrën se si do të operojë për këtë marrëveshje. Çfarë thoni ju? Ne e dimë edhe sistemin 5G, që e ka Kina dhe shumë vende të tjera, që janë shumë. Po çfarë po bëjmë ne këtu, pazar, që të nxjerrim kompani apo individë të tjerë që na ofrohen për ta marrë këtë sistem? Pse këtu mbetën që të përfitojnë këto? Jo, zotëri! Këtu bëhet fjalë për autoritetin e një shteti, për autoritetin e forcave të NATO-sa si pjesëtarë të forcave të NATO-s, ndaj duhet në vëmendjen e gjithsecilit që të mbahet në konsideratë. Nuk mund të konsiderohet kjo si një çështje që hajde ta hedhim në treg, se këtu nuk po nxjerrim përfitimet, që do t'i marrka Kryeministri Rama apo qenka ortak edhe me këtë.

Problemi tjetër ka të bëjë me arrestimet e sotme, i cilat i përmendni shumë. Kjo tregon se funksionon sistemi i drejtësisë, nuk është ashtu siç e le ti Alibeaj. Në fakt, ti nuk ke qenë, se ke bërë disa kohë pushim...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Po them që reforma në drejtësi po tregon se ne jemi të gjithë të barabartë dhe jo se nuk funksionon, por për aq kohë sa drejtësia të shprehet deri në fund, le të heshtim. Ndoshta ti je pak i aluduar dhe ke ankthin e vendimit të fundit, që u dha nga gjykata, por lërja këtë sistemit të drejtësisë. E dëgjova njërin atje me të drejtë në ato komentet që jepte dhe thoshte që kanë shkuar në gjykatë burri dhe gruaja dhe ankohet komshiu. Lëreni sistemin e drejtësisë të flasë, mos t'ju vijë keq për vendimin e gjykatës.

Për t'u futur tek tema, të nderuar kolegë, e tha me të drejtë kolegja Resulaj, që është specialiste e mirëfilltë e financës dhe një ndër njerëzit më të përshtatshëm në këtë sektor, pa lënë mënjane sekretaren e komisionit, këtu kemi të bëjmë me një kompani serioze, e cila i merr edhe atributet e saj në funksion të autoritetit që ka kjo kompani lider. Ta lejojmë dhe t'i japim dritën jeshile që të negociohet dhe të arrihet një marrëveshje serioze, të shikohet gjendja reale, e cila është për të ardhur keq që është nën nivelin e duhur. Le të jemi një shtet serioz, që të disponojmë të dhëna jo vetëm në dispozicion të NATO-s, por edhe në dispozicion të të gjithë sistemit në tërësi.

Ju ftoj, të nderuar kolegë, që ta votojmë këtë projektligj dhe të krijojmë një mundësi, sepse kështu rrisim edhe sigurinë kombëtare në vend.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Qefalia!

Fjala për zotin Noka.

Më pas për zotin Kollçaku dhe Sinaj.

Flamur Noka – Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegu Qefaliaj në pamundësi për të mbrojtur atë që duhej të mbronte, u mundua të bënte diversion brenda opozitës. Xhemal, mos u merr se çfarë ndodh në oborrin e komshiut, por shikoni oborrin tuaj, se janë duke plasur mina çdo ditë! Ne i zgjidhim vetë punët tona, ne e gjejmë gjuhën tonë me njëri-tjetrin, pavarësisht ndonjë mendimi ndryshe që mund të ndajmë. Shikoni se janë duke ju plasur minat çdo ditë brenda shtëpisë, në oborr e gjithandej, derisa t'ju plasë një minë e madhe, ruhuni e bëni kujdes!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pak më shumë se gjyle është, zoti Nasip, kur t'ju vijë, por prisni se do t'ju vijë shpejt!

Për sa i përket çështjes, mund të them se është tjetër gjë konsiderata për gjeneralin Jones, qoftë edhe për shoqërinë e tij “Jones Group International”, dhe është tjetër gjë procedura që shpikni ju për të bashkëpunuar me këtë shoqëri. A jemi të kënaqur, që një shoqëri amerikane do të operojë? Po, pa as më të voglin diskutim, por po jua them përsëri, zoti Alibeaj ju drejtoi gishtin atje ku juve ju djeg shumë, procedurat korruptive që ndiqni për të ecur në këtë drejtim. Edhe kur realizoni një partneritet apo një bashkëpunim me një kompani amerikane, përsëri dritëhija e korrupsionit juve ju ndjek dhe ky është i gjithë problemi. Nuk është problemi as te gjenerali, të cilit i detyrohemi një mirënjohje pa fund, jo vetëm ne, por çdo shqiptar. Unë e njoh personalisht dhe e di kontributin e tij madhor në çështjen e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, por kjo nuk do të thotë që ne do të mbyllim sytë para gjithçkaje që bëni ju. Me falni, jo juve, por qeveria juaj! Koha ka vërtetuar që kur flitet për një procedurë prokurimi në qeverinë tuaj bie era korrupsion, kur flitet për një procedurë prokurimi, ju shpikni ligje për negociime dhe bëni procedura negociimi gjithmonë dhe, çuditërisht, me shifra 100% në kokë, se demokracia ka 30 vjet në këtë vend, nuk ka 3 ditë. Si ka mundësi që qeveria juaj është e dashuruar me procedurat e negociimit dhe me shifra në kokë?! Sepse nuk doni t'ia dini as për kursimet e taksave të shqiptarëve, nuk doni t'ia dini për asgjë tjetër. Kaq është çështja që ngre opozita, Partia Demokratike dhe kryetari i Grupit Parlamentar, zoti Alibeaj. Çfarë doni ju? Doni që t'ju ngremë ndonjë çështje tjetër? Jo, vetëm kaq. Ne kujdesemi për taksat e shqiptarëve dhe shikojmë që siç janë vjedhur këta 9 vjet, po tentohet të vidhen në çdo procedurë.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Noka!

Zoti Kollçaku.

Bardhyl Kollçaku – Faleminderit, zoti kryetar!

Të dyja palët bien dakord që kemi të bëjmë me një kompani serioze të ndershme të një miku dhe aleati strategjik. Marrim për një moment të kundërtën, që nuk është e ndershme. Atëherë, Edi Rama, ministria apo qeveria me kë do ta bëjë këtë korrupsion, që do të përfitojnë dhe do të marrin lekë? Përsëri me Jones Group dhe me gjeneralin Jones.

Qeveria shqiptare në të gjithë historikun e saj ka pasur dhe ka kontrata me Lockheed Martin, me Raytheon General Dynamics edhe kur keni qenë ju në pushtet, por edhe tani që jemi ne. Të vetmet kontrata, që nuk janë diskutuar asnjëherë, kanë qenë kontratat me partnerët tanë amerikanë. Unë jo

vetëm që nuk e kuptoj, por edhe analogjinë që bëri kolegu Alibeaj me ligjin për prokurimet ushtarake është i pa...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk futet këtu, për arsye se unë vij nga ajo fushë dhe e di shumë mirë se cilat janë mallrat për shërbime ushtarake, ndaj nuk bëhet fjalë për ato, por bëhet fjalë për ato që kanë të bëjnë cilësisht me tanket, avionët, me armatimet e të tjera.

Siguria kibernetike ka dy probleme: rrjetet dhe informacioni. Rrjetet janë jo vetëm ato që kalojnë te Ministria e Mbrojtjes, te Ministria e Brendshme, tek organet e sigurisë publike, por janë edhe ato tek energjetika, tek ujësjellësi e kudo, ndaj duhet t'i kuptojmë si një të tërë. Siguria kombëtare kibernetike kërkohet nga aleanca, është detyrim, sidomos pas konfliktit Rusi – Ukrainë, është detyrim i Samitit të Uellsit, është detyrim i anëtarësimit tonë, që kur është bërë siguria kibernetike domeni i pestë. Ndaj, unë nuk shikoj asnjë merak dhe nuk duhet të bëhet asnjë lidhje e kësaj procedure apo e këtij autorizimi me të tjerat që i keni në mendje ose që kanë ndodhur më përpara, sepse ky është një projektligj jo vetëm në një linjë me prokurimet publike, por edhe me kërkesën imediate për sigurinë kombëtare, për sigurinë kibernetikë.

Faleminderit!

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Flamur Noka – Duke dashur të mirëkuptoj çdo koleg, problemi është shumë i thjeshtë. Unë po jua bëj me dije edhe për faktin se e njoh dhe e di, si dhe për faktin që ka kontribuar, ne nuk jemi kundër, por kërkojmë transparencë. Në një projektligj të tillë përsëri nuk ka transparencë. Ne kaq kërkojmë. Pse? Është fat i madh që një kompani amerikane merr përsipër t'i krijojë sigurinë kibernetike vendit tonë, pa diskutim. Nëse nuk do të ishte shoqëria *Jones Group International*, mund të dyshoja edhe unë. E dini pse? Sepse për qeverinë, për Edi Ramën, mund të ishte *George Soros International*, pasi ndodh, ka ndodhur në qeverinë tuaj këto vite. Kjo është e vërteta.

Kolegu Qefalia përmendi historinë e 5G-së.

Xhemal, Kryeministri yt, që ti e nxjerr si pro amerikan, ia dha Kinës 5G-në. Pas ndërrhyrjes dhe presionit të SHBA-së, u kthye dhe u anulua. Ka dal publikisht, kështu që mos vuani kaq shumë!

Kjo kompani është serioze, është personalitet serioz.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Noka!

Zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Ky është problem delikat dhe mua më vjen keq që u ndamë dhe diskutojmë ndryshe, sepse në parim, të dy krahët, deputetët e Partisë Socialiste dhe deputetët e Partisë Demokratike jemi dakord që siguria kibernetike është e nevojshme.

Njëkohësisht, biem dakord që gjenerali Jonson është një figurë që ka kontribuar në interes të vendit tonë, por i gjithë defekti është te propozimi i drejtpërdrejtë i emrit të firmës. Mos ndoshta do të

ishite e nevojshme të ishim ulur bashkë, të bënim një mbledhje më të mbyllur për të diskutuar rëndësinë, sepse është normale që nuk mund t'ia japim këtë tender një firme ruse, apo një firme tjetër.

Zoti kryetar, mendoj se duhet ta bënim më parë këtë dakordësi, të ishte prezantuar më mirë mënyra e ardhjes së këtij projektligji.

Të jemi të vetëdijshëm, kemi pasur defekte dhe gabime, por në rastin e sigurisë, unë jam kundër me ju, zoti Alibeaj, kur e trajtoni problemin sikur kjo bëhet për korrupsion e të tjera. Unë i jap shumë rëndësi Komisionit të Sigurisë Kombëtare dhe temës që ne trajtojmë sot, që ka të bëjë me sigurinë kombëtare. Pashë që e gjithë fryma ishte pro sigurisë kombëtare, pro domosdoshmërisë së kësaj teme, por cedojmë vetëm në një pikë të vogël, të cilin mund të mos e kishim bërë kaq shumë publike, të bënim një mbledhje pa mediet, të diskutonim dhe të binim dakord bashkërisht, dhe këtu mund të vinim për të votuar. Nuk ishte e nevojshme të bëhej i gjithë ky diskutim.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe shpresoj se duke menduar së bashku që kjo është firmë serioze amerikane, edhe pse pati një debat të vogël, ju ftoj ta miratojmë!

E besojmë zotin Noka për fjalët e tij, sepse e njej drejtpërdrejt gjeneralin dhe firma amerikane është e një partnerit tonë të NATO-s, por do të ishte mirë të mos ishin bërë këto debate në komision, por të gjenim një mënyrë tjetër për ta kaluar më lehtë këtë gjë, sepse nuk mund të bënim kaq ...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Nuk na shkon.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Unë nuk merrem me lekë, sepse rrogën e kam falur, por problemi është më i rëndësishëm se sa lekët, është më e rëndësishme pjesa e sigurisë kombëtare. Kjo është rëndësia më e madhe.

Sot, në këtë situatë, ne biem dakord se është shumë e rëndësishme të kemi një siguri kombëtare të fortë dhe një mbrojtje nga sulmet kibernetike, me diçka të vogël, që mund ta kishim rregulluar shumë herë më mirë pa bërë këto debate.

Faleminderit!

Nasip Naço – Po, zoti Mahmutaj.

Kasëm Mahmutaj – Për sa i përket firmës, autoritetit kontraktor *Jones Group*, duke e zënë shumë në gojë, sikur i bëjmë keq.

Këtu ka diçka: zoti Sina tha se ne biem dakord parimisht.

Gjithsesi, edhe opozita është dakord, mendoj unë, por jo për t'u futur në një kurth dakordësie, që thjesht ta kalojmë sot. Ligjet duhet të ndërtohen në formë të tillë, që të mos cenojnë interesin, dinjitetin e kompanive apo të shtetit tonë.

Në pikën 2 të nenit 6 thuhet: “*Jones Group* cakton një nga degët e tij të nënshkruar në kontratën me autoritetin kontraktor me miratimin e këtij të fundit”. Sipas kësaj pike, një degë ka kuptimin e një shoqërie nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose jo.

Ne sot mund t'i shikojmë, t'i korrektojmë dhe të mblidhemi nesër për të vendosur, cili do të jetë dakord, duke respektuar edhe opozitën, që të ndërtojmë një kuadër ligjor, që të na ndihmojë ne, shtetin shqiptar dhe të na mbrojë nga sulmet kibernetike. Ky është sugjerimi im.

Nasip Naço – Zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se në kushtet kur shoqëria e përzgjedhur ka eksperiencë të mjaftueshme në fushën e konsulencës, të zgjedhjes së produkteve në fushat e sigurisë kibernetike, të energjisë, të telekomunikacionit, të inxhinierisë, të transformimit organizativ, për çështjet tregtare dhe politike, dhe në kushtet kur ky projektligj i domosdoshëm i vjen në funksion jo vetëm agjencive të mbrojtjes kombëtare, por të gjitha agjencive civile qeveritare, propozoj ta miratojmë këtë projektligj, sepse është shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Dhima!

Të nderuar kolegë,

Meqenëse mbaruam pyetjet dhe diskutimet, do të kalojmë në miratimin në parim, nen për nen dhe në tërësi të këtij projektligji.

Do të doja të ndaja të njëjtat shqetësime që ngritën për këtë projektligj kolegët e opozitës dhe mazhorancës.

Në fillim kërkova përmirësime dhe amendamente nga opozita apo mazhoranca, qoftë edhe në formën pyetjesh, për ta përmirësuar projektligjin. Para nesh kemi këtë projektligj. Do të zbatojmë, do të miratojmë këtë, apo do të vazhdoni me procedurat e ligjit “Për prokurimet publike”?

Qeveria ka zgjedhur të sjellë një projektligj të veçantë për shkak të situatës, të emergjencës për daljen e të dhënave, për të operuar në këtë mënyrë. Pra, këtu nuk ka të bëjë një kompani apo një tjetër, por vetëm ana ligjore.

Për pjesën tjetër, nëse ne cedojmë në një pikë apo një tjetër, kemi disa filtra, Presidentin e Republikës dhe Gjykatën Kushtetuese, ku kushdo nga ju, që nuk është dakord me miratimin, ka të drejtë, sipas Kushtetutës, t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

Personalisht, nuk do të më vinte mirë që një projektligj i miratuar, i dalë nga Komisioni i Sigurisë, qoftë edhe për një nen të veçantë, të ndryshohet në Gjykatën Kushtetuese. Për aq kohë sa kam qenë në parlament, për aq kohë sa kam votuar këto vite, në asnjë rast të vetëm, asnjë nen nga ato që kam kaluar, nuk është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese.

Jam i bindur se duke kaluar nen për nen, mund të ketë edhe mendime të ndryshme dhe amendamente.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Vazhdojmë me këtë pikë të rendit të ditës.

Në fillim do të miratojmë procesverbalet e mbledhjeve së komisionit datë 31.01.2022, datë 08.02.2022, datë 09.02.2022.

Kush është dakord?

Miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe zbatimin e kontratës me shoqërinë *Jones Group International* “Për forcimin e sigurisë kibernetike””.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3.

Kush është dakord me ndryshimet, që te “Procedura para negociatave”, të shtohet një pikë 3.2 dhe të riformulohet: “Një përfaqësues i autoritetit kombëtar për certifikimin elektronik dhe sigurinë kombëtare, një përfaqësues nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar DSİK” dhe te pika 3, “si edhe pajisjen e këtyre anëtarëve me certifikatë sigurie, sipas legjislacionit në fuqi”? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Bardhyl Kollçaku – Unë jam i mendimit që pajisja me certifikatë sigurie jo vetëm që vonon, por ka problem ...

Nasip Naço – Më parë pyeta kush kishte amendament.

Nëse ke amendament, bëje propozimin.

Bardhyl Kollçaku – Jo, nuk kam amendament.

Nasip Naço – Nuk do të vijojmë me diskutime.

Nëse ke amendament, bëjmë 5 minuta pushim dhe bëjmë amendament.

Ke votë kundër? Ke amendament?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si e ka?

Ta riformulojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Kollçaku, ju lutem, të kaloj në pikën tjetër? Do të bëni amendament, sepse nuk do të vazhdojmë me pyetje dhe diskutime? Nëse keni amendament për mënyrën se si e mendon, ta diskutojmë me përfaqësuesit dhe ta votojmë.

Bardhyl Kollçaku – Para se të shkojmë në votim, dëgjova përfaqësuesit e ministrisë dhe rezervat që kanë, që pajisja me certifikatë sigurie vonon.

E dyta, kemi eksperiencë nga kontrata të tilla në Ministrinë e Mbrojtjes, që kërkesa për klasifikim të dokumentacionit ose certifikatës së sigurisë personale, e ka shtyrë më shumë, sidomos kur ka të bëjë me të huajt, sepse përdorin të tjera standarde.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di, por kur të jem në takim, do të jenë edhe përfaqësuesit e firmës, ndaj standardi do të jetë i njëjtë.

Mendoj se për këtë duhet të shprehet ministria, ose duhet ta kishim biseduar me DSIK-në para se të votojmë. Ky është merak im, dua ta ndihmoj procesin, jo ta pengoj.

Nasip Naço – Dakord, zoti Kollçaku, por në këtë moment nuk qëndron. Pyetjet dhe diskutimet mbaruan. Nëse ke amendament, dakord, por nëse nuk ke, mund të votosh kundër, që të jesh i ndërgjegjshëm me veten tënde.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është diktaturë.

Do të procedojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Neni 3.

Kush është dakord me propozimet e bëra? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4.

Kush është dakord me ndryshimet që u propozuan? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër, zoti Mahmutaj. Abstenim?

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem!

Zoti Mahmutaj, keni komente për të shpjeguar votën kundër?

Nuk keni.

Neni 7.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8.

Kush është dakord me ndryshimin që i bëhet pikës 2, nga neni 3, të kalojë neni 4? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi me ndryshimet e propozuara.

Kush është dakord me projektligjin “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe zbatimin e kontratës me shoqërinë *Jones Group International* “Për forcimin e sigurisë kibernetike”, në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

I falënderoj të ftuarit dhe kolegët!

MBYLLET MBLEDHJA